



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESIS- MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Nr. esia Org. O. g. Jedinica Org Unit	01	Nr Prot: Broj Pro: Prot. No	05-3527
Nr. i faqeve Br. stránice No. pages	-04-	Data Datum Date	13, 06, 2013
Prishtinë / La			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
në mes të:

Ministrisë së Drejtësisë, të cilën e përfaqëson Prof. Dr. Hajredin Kuçi,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë,
dhe

Ministrisë së Shëndetësisë, të cilën e përfaqëson Prof. Dr. Ferid Agani,
Ministër i Shëndetësisë

I.

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje bashkëpunimi në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (Nenin 19.3), Rregulloren nr. 02/2011 për fushën e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (neni 8. pika 1.4), si dhe me qëllim të zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi (neni 35 paragrafi 1 dhe 2), pajtohen që të bëhet delegimi i kompetencave për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor në Institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë.

II.

1. Delegimi i kompetencave nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë do të mundësoj ofrimin e kujdesit shëndetësor kualitativ për të gjithë personat që janë në mbajtje të dënimit në Institucionet Korrektuese, me standarde ekuivalente me ato që ofrohen për qytetarët në liri, në pajtim me Rregullat Evropiane për burgje dhe Rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për trajtim shëndetësor adekuat dhe profesional.

2. Pas delegimit të kompetencave nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë do të jetë institucioni përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të kujdesit shëndetësor në Institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

III.

1. Me delegimin e kompetencave sipas kësaj marrëveshje nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë, do të transferohen të gjithë punëtorët shëndetësor të Shërbimit Korrektues/Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa objektet do të mbeten pronë e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Pajisjet, medikamentet, mjetet e punës dhe inventari barten në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë për shfrytëzim nga shërbimi i kujdesit shëndetësor në Institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës.
3. Dokumentacioni aktiv dhe arkiva mbetet pronë e Ministrisë së Drejtësisë kurse Ministria e Shëndetësisë/shërbimi i kujdesit shëndetësor në Institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës ka të drejtë qasje për qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisive të këtij shërbimi.

IV.

1. Palët nënshkruese pajtohen që transferimi i punëtorëve shëndetësor dhe personelit menaxhues të Sistemit Shëndetësor të Burgjeve në Ministrinë e Shëndetësisë do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
2. Sektori i Administratës së Përgjithshme dhe sektorët përgjegjës të Shërbimit Korrektues të Kosovës në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshje duhet të përfundojnë raportin për evidentimin e pasurisë, hapësirave të punës, inventarit, aseteve, arkivit, dosjeve të personelit, të dhënave dhe pajisjeve të tjera të cilin raport duhet t'ia dorëzojnë Komisionit për pranim/dorëzim.

3. Me transferimin e personelit do të bëhet edhe transferimi i buxhetit i miratuar për vitin 2013 si në vijim: Paga dhe mëditje 528,983.41, kurse për kodet ekonomike (kodi ekonomik 13630 barëra dhe material mjekësor në shumën 115,000; Kodi ekonomik 13430 –Shërbime të ndryshme mjekësore në shumën 53,498; kodin ekonomik 13506-Pajisje speciale mjekësore në shumën 10,000) nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë.
4. Bartja e buxhetit nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë, bëhet në vlerën e mbetur të buxhetit të miratuar më parë sipas shumës në pikën 3, ashtu siç është duke u zbatuar për vitin 2013, për 111 pozitat e punëtorëve shëndetësor aktual të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku përfshihen edhe pozitat e lira që duhet të rekrutohen.
5. Deri në rishikimin e buxhetit të Kosovës, të gjithë punëtorët shëndetësor të transferuar në Ministrinë e Shëndetësisë do të vazhdojnë të paguhen nga Ministria e Drejtësisë.
6. Për periudhën deri në fund të vitit 2013, Ministria e Drejtësisë mbanë përgjegjësinë për mbulimin e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme dhe të planifikuara më parë.
7. Me përfundimin e vitit kalendarik 2013, Ministria e Shëndetësisë merr të gjitha përgjegjësitë për mbulimin e shpenzimeve për funksionimin e sistemit shëndetësor në institucionet korrektuese.

V.

1. Transferimin e Personelit, dhënien në përdorim të hapësirave për përdorim nga personeli i transferuar për ofrimin e kujdesit shëndetësor në Institucionet Korrektuese, arkivit, dosjeve të personelit, dhe të dhënave tjera të Sektorit të Sistemit shëndetësor në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, e kryen komisioni për pranim dorëzim të cilin e themelojnë me vendim Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Komisioni për pranim dorëzim gjithashtu ka për detyrë të përgatis listën e pozitive dhe punëtorëve shëndetësor të transferuar nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë.
3. Procesverbali i përpiluar nga Komisioni për pranim dorëzimit e aseteve dhe dokumenteve si dhe lista e punëtorëve shëndetësor të transferuar në Ministrinë e Shëndetësisë do ti bashkëngjitet kësaj marrëveshje.

VI.

1. Palët nënshkruese pajtohen që çfarëdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje të zgjidhet me diskutime të përbashkëta deri në arritjen e një marrëveshje.
2. Dispozitat e kësaj marrëveshje për ofrimin e shërbimeve shëndetësore do të vlejnjë deri në miratimin e aktit nënligjor nga Qeveria e Kosovës në pajtim me nenin 35 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

VII.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet në katër (4) kopje, dhe secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje të nënshkruara.


VIII.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prof. Dr. Hajredin Kuçi,
Zëvendëskryeministër dhe
Ministër i Drejtësisë



Prof. Dr. Ferid Agani,
Ministër i Shëndetësisë



Prishtinë me datë 13/06/2013